



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 24.02.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.02.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Vlera" për aktivitetin: "Dezinfektimi,dezinspektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-3417-221 nxjerr:

### VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Vlera" e datës 22.02.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi,dezinspektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-3417-221, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 18.02.2021*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. Vërtetohet *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 18.02.2021*;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "Vlera" me datë 18.02.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinfektimi,dezinspektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-3417-221.

Autoriteti Kontraktues, me datë 24.02.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet tuaja për shkelje të dispozitave ligjore janë të pa bazuara, pasi që Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procesin e rivleresimit në harmoni të plotë me Vendimin e OSHP-se e që respektimi i të njëjtit është i detyrueshem. Edhe perkunder kesaj pasi që dilema jone lidhur me tenderuesin e propozuar ka pase te beje me nje dokument lidhur nderhyrje ne te nejjtin ne kemi kerkuar qe tenderuesi ta deshmoje se dokuemnti me date te validitetit te produktit ka gene dokument origjinal. I njëjti e ka sjell origjinalin dhe deshmite e komunikimeve me prodhuesin lidhur me deshmine. Prandaj bazuar në këto deshmi dhe në rekomandime qarte të Vendimit të OSHP-se i njëjti është propozuar për dhenje të kontrates;

Poashtu pretendimet tuaja se jeni tenderues i pergjegjshem dhe se eshte dashte te kerkohen sqarime plotesuese eshte ne kundertshtim me Vendimin e OSHP-se sipas te cilit ankesa juaj eshte trajtuar si e pa bazuar dhe sipas kesaj ju jeni tenderues i pa pergjegjshem.

Bazuar ne keto sqarime u vendos si ne dispozitiv te Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

**Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

